



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
Sektori i Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Nr. 34919/2 Prot.

Tiranë, më 24.10.2016

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Saimir KODRA
Drejtor i programit "STOP", Televizioni KLAN
Rr."Aleksandër MOISIU", Nr.97

TIRANË

I nderuar z.Kodra,

Në cilësinë e kërkuarit, keni depozituar në formë shkresore, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar në regjistrin e kërkesave bazuar me numër rendor 3 datë 21.10.2016, bazuar në Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit, si dhe protokolluar në DPT nr.34919 Prot, datë 20.10.2016, në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore të subjektit me NIPT L31418016M, me emër tregtar Intermarket dhe pronar Agim Ali Kotorri.

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, në nenin 24, "Dhënia e informacionit tatimor nga administrata tatimore", përcakton në mënyrë të qartë autoritetet, të cilave Administratat Tatimore mund t'iu ofrojë informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj, dhe konkretisht citojmë: *"Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:*

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;*
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;*
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;*

- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;*
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;*
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;*
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.”*

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar prej jush nuk mund t’ju vihet në dispozicion.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VASILIKA VJERO



- Raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit publikohen në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.
- Informacion mbi procedurat e prokurimit etj : <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/E%20Drejta%20Per%20Informim/Pages/Per-Procedurat-e-Prokurimit.aspx>
- Numri i kërkesave të depozituara pranë DPT për periudhën janar – shtator 2016 është 3 kërkesa, nga të cilat 2 janë konsideruar si të tilla në kuptim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit dhe janë regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”. Kërkesa e tretë nuk i përmbushte kushtet e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi kërkuesi z.Leka Filto nuk kërkonte informacion publik të lidhur me veprimtarinë e Administratës Tatimore, por informacion lidhur me funksionimin e një grupimi të caktuar biznesesh.
Numri i kërkesave të cilat kanë marrë përgjigje është: 2, (bashkëngjitur kopje e përgjigjeve) si dhe i është kthyer përgjigje z. Leka Filto (sipërpërmendur).
Numri i kërkesave të cilave iu është refuzuar dhënia e informacionit është: 0
Në 2 kërkesat e paraqitura për periudhën Janar - Shtator 2016, kërkohet informacion në lidhje me numrin e OJF-ve të regjistruara në Administratën Tatimore.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është ngritur një grup pune për përmirësimin e faqes zyrtare të internetit, me qëllim për t’a bërë përmbajtjen e saj më të kuptueshme si dhe më lehtë të aksesueshme nga tatimpaguesit dhe publiku.

Për lehtësi përdorimi nga ana juaj, ky informacion do t’ju dërgohet edhe në mënyrë elektronike në adresën tuaj të emailit: dorian.matlija@gmail.com

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VASILIKA VJERO

